



# RAPORTI VJETOR 2019



# RAPORTI VJETOR 2019



Republika e Shqipërisë  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", nr. 3 Tiranë.  
Tel: +355 42 24 4 602  
[www.fiu.gov.al](http://www.fiu.gov.al)

# PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	4
MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	5
NDRYSHIME TË RËNDËSISHME LIGJORE GJATË VITIT 2019	6
MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRA E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM	7
Raportet e aktivitetit të dyshimtë	8
Analizimi dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit	10
Urdhrat e bllokimit të përkohshëm	13
TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE	14
Tipologji 1: Transferta të kryera nga shtetas me precedentë penal	14
Tipologji 2: Transferta të dyshimtë nga shtetasi i një vendi me risk	15
Tipologji 3: Transferta të dyshimta të përfituara nga kryerja e një aktiviteti ekonomik fiktiv	17
Tipologji 4: Transferta të larta në mbërritje në favor të shoqërive Call Center.	18
Tipologji 5: Transferta të dyshimtë në mbërritje nga një shtetas i një vendi me risk në Lindjen e Mesme	19
ANALIZA STRATEGJIKE	20
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTSHMËRISË	21
Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese	21
Analizimi i përputshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë	23
MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE	25
Masat administrative	25
Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore	27
BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR	28
Bashkëpunimi kombëtar ndër-institucional	28
Bashkëpunimi ndërkombëtar	30
Shkëmbimi i informacioneve me NJIF	30
Procesi i vlerësimit nga komiteti Moneyval i KiE	31
BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI	32
Buxheti dhe menaxhimi i tij	32
Menaxhimi i burimeve njerëzore	34
Teknologjia e informacionit	36
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2020	37

## SHKURTIMET

<b>AMF</b>	- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
<b>ASHK</b>	- Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>BE</b>	- Bashkimi Evropian
<b>BSH</b>	- Banka e Shqipërisë
<b>DPD</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
<b>DPPPP</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
<b>DPPSH</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>DPT</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DSIK</b>	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
<b>Egmont</b>	- Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
<b>FATF</b>	- Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
<b>ILDKPKI</b>	- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
<b>IFJB</b>	- Institucione Financiare Jo-Bankare
<b>KiE</b>	- Këshilli i Evropës
<b>Moneyval</b>	- Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
<b>NjIF</b>	- Njësi e Inteligjencës Financiare
<b>OSBE</b>	- Organizata për Bashkëpunim dhe Sigurinë në Evropë
<b>PP/FT</b>	- Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit
<b>PP</b>	- Prokuroria e Përgjithshme
<b>OJF</b>	- Organizatë Jo-Fitimprurëse
<b>QKB</b>	- Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>RAD</b>	- Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
<b>RTPF</b>	- Raporti i Transaksioneve në Para Fizike
<b>ZKV</b>	- Zyrë Këmbimi Valutor
<b>TI</b>	- Teknologjia e Informacionit
<b>UNODC</b>	- Zyra për Drogën dhe Krimet e Kombeve të Bashkuara

# MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin vjetor të vitit 2019. Ky raport do të parashtrojë drejtimet, veprimtaritë kryesore të punës tonë, ndryshimet realizuara, rezultatet, problematikat dhe objektivat e Njesisë së Inteligjencës Financiare.

Veprimtaria e DPPP-së gjatë këtij viti ka qenë shumë planëshe dhe përpos rolit primar si Njësi e Inteligjencës Financiare në Shqipëri, është përqendruar edhe në kryerjen me efektivitet të rolit mbikëqyrës të zbatimit nga subjektet e ligjit të legjislacionit në fuqi, trajnimit të vazhdueshëm të subjekteve të ligjit, në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit Shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të BE-së, raportimi pranë Komiteti MONEYVAL dhe Grupit ICRG të FATF, në kuadër

të procesit të vlerësimit të Shqipërisë.

Gjatë vitit është përmbyllur edhe dokumenti për vlerësimin kombëtar të riskut për PP/FT, dokument i cili në përmbushje të standardeve ndërkombëtare, nevojave dhe të detyrimeve kombëtare, evidenton problematikat në drejtim të mbikëqyrjes dhe hetimit, veprat kryesore të origjinës së pasurisë kriminale, faktorët që ulin dhe rrisin riskun si dhe kërcënimet.

Pjesë e punës ka qenë edhe bashkëpunimi me strukturat e reja të vlerësimit kalimtar të Gjyqtarëve / Prokurorëve por edhe të zyrtarëve të lartë të Policisë.

Në përfundim, dua të vlerësoj maksimalisht përpjekjet, përkushtimin dhe punën e kolegëve të DPPP-së, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur arritjen e rezultateve të prezantuara në këtë raport.



# NDRYSHIME TË RËNDËSISHME LIGJORE GJATË VITIT 2019



Gjatë vitit 2018 vendi ynë i është nënshtruar raundit të pestë të vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, raporti i publikuar në datën 05 Korrik 2018. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së.

Në kuadër të nevojës për reflektimin dhe adresimin e rekomandimeve dhe kriterëve përkatëse të rekomandimeve janë miratuar aktet e mëposhtme.

1. Ligji nr. 33/2019 datë 17.6.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (të ndryshuar);

Në fokus të amendimeve kanë qenë rekomandimet që janë vlerësuar si të papërbushura apo të përbushura pjesërisht, si transparenca dhe pronësia përfituese e organizimeve ligjore, vigjilenca e duhur ndaj klientit, mbështetja në palë të treta, personat e ekspozuar politikisht, vlerësimi i riskut dhe qasja e bazuar në risk, transfertat, kontrolli i brendshëm i degeve dhe filjaleve të huaj,

konfidencialiteti dhe mosdeklarimi, mbajtja e të dhënave, vendet me risk të lartë.

2. Ligji nr. 32/2019 datë 17.6.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit” (të ndryshuar);

Me këtë ligj është synuar përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6 i FATF, kriteret përkatëse të këtij rekomandimi si dhe rezultati imediat 10, elementë këta në tërësi të vlerësuar si pjesërisht të përbushur. Vlen të evidentohet rëndësia e posaçme e përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6, pasi ai bën pjesë në grupin e atyre që konsiderohen kyçe në sistem parandalues dhe goditës ndaj terrorizmit dhe financimit të tij.

3. Vendimi Nr. 847, Datë 24.12.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 343, Datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe mbikëqyrëse”

Ky vendim përditëson emërtesat e autoriteteve mbikëqyrëse dhe licencuese, si dhe zgjeron kompetencat e organeve mbikëqyrëse dhe licencuese në mbikëqyrjen e të gjitha detyrimeve ligjore kundër PP/FT.

# MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRAT E BLLOKIMIT TË PËRKOHSHËM



Një nga funksionet më të rëndësishme të DPPP është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës.

Burimi më me rëndësi në sistemin parandalues mbeten raportimet e transaksioneve të dyshimta nga një sërë subjektsh raportuese dhe institucioneve shtetërore, në përputhje me ligjin, standartet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.

Një informacion tjetër thelbësor për analizimin e rasteve përbëjnë edhe kërkesat për bashkëpunim nga NJIF partnere, kërkesat nga institucionet vendase, si dhe analizat e ndryshme sektoriale. Gjatë analizimit të informacioneve të siguruar nga këto subjekte apo institucione, përcaktohen prioritetet e rasteve, bëhet analizimi i të dhënave që disponohen dhe në rast se konstatohen dyshime, dërgohen më tej për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligjzbatuese, si dhe nëse është e nevojshme merren edhe masa për bllokim të përkohshëm të transaksioneve.

Duke marrë në konsideratë analizën e përgjithshme të të dhënave statistikore të paraqitura në vijim, del në pah përmirësimi i vazhdueshëm dhe fokusimi më tej në sistemin parandalues. Kështu, konstatohet:

- rritje të RAD të dërguara nga ato subjekte raportuese që zënë peshën kryesore në parandalimin e PP/FT si bankat dhe shoqëritë e transfertave, por dhe përmirësimi i vazhdueshëm në cilësinë e raportimit të subjekteve në tërësi;
- rritje të fondeve të bllokuara dhe të sekuestruara nga Gjykata në krahasim me vitin e mëparshëm, duke ruajtur një tendencë konstante të raportit të fondeve/pasurive të sekuestruara mbi ato të bllokuara, për tre vitet e fundit;
- thellimi i mëtejshëm në informacionin e dërguar në organet ligjzbatuese me të dhëna të plota dhe të argumentuara financiare, për të rritur më tepër efektivitetin e ndjekjes së mëtejshme të rasteve në organet kompetente.

## Raportet e aktivitetit të dyshimtë

Për institucionin tonë, dërgimi i RAD-ve nëpërmjet subjekteve të ligjit, është një proces mjaft i rëndësishëm dhe thelbësor për vetë rolin që DPPPP ka në parandalimin e PP/FT.

Gjatë vitit 2019, në DPPPP janë dërguar 1,424 RAD nga subjektet raportuese, të përshkruara në vijim në tabelën 1. Këtë vit vihet re se në total janë dërguar 6.62 % RAD më pak, në krahasim me RAD e dërguara vitin e kaluar dhe kjo ka ndodhur për arsye se disa subjekte janë ndërgjegjësuar më tepër në drejtim të rritjes së cilësisë të RAD-ve të dërguara sipas prioriteteve që kemi në funksion të parandalimit të PP/FT dhe jo thjesht për raportimin e tyre. Disa nga subjektet që kanë pësuar rënie janë: noterët, ASHK, shoqëritë e institucioneve të qiradhënies financiare dhe shoqëritë e pagesave

elektronike etj.

Për sa i përket uljes së numrit të raportimeve të RAD-ve nga noterët konstatojmë se kjo mund të ketë ardhur për shkak të uljes së raportimeve nga dy prej tyre, pas trajnimeve të kryera nga DPPPP dhe ndërgjegjësimi për rritjen e cilësisë së raportimit dhe fokusimin në rastet me indicje dhe anomali të mirëfillta në funksion të PP/FT.

Ajo çfarë vërehet tjetër është se bankat dhe shoqëritë e transfertave pasqyrojnë një rritje në numrin e RAD-ve të dërguara, tregues ky i rëndësishëm për vëmendjen e treguar në rritje nga ana e tyre për çështjet e PP/FT.

Tabela 1: RAD të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve raportuese për periudhën 2015-2019:


Subjekti raportues	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Banka	585	619	686	563	651
Shoqëri transfertash	79	209	165	247	319
DPD	45	47	46	49	43
DPT	7	3	5	10	12
ASHK	210	134	83	164	33
Noter	303	205	254	469	335
ZKV	17	14	20	7	6
Shoqëri auditimi	0	1	0	0	0
Ekspert kontabël	1	0	0	0	0
Inst. financiare të mikro-kredisë	0	2	10	2	0
Avokat	0	0	0	0	0
Shoqëri të qiradhënies financiare	7	15	5	2	0
Shoqëri ndërtimit	1	0	5	0	5
Shoqëri tregtimi mjetesh motorike	36	35	101	6	10
Agjenci udhëtimi	1	0	0	0	0
Shoqëri kursim krediti	1	0	0	0	0
Shoqëri transporti	2	0	0	0	0
Shoqëri pagesash elektronike	19	6	2	6	0
Tjetër	5	2	2	0	10
<b>Total</b>	<b>1,319</b>	<b>1,292</b>	<b>1,384</b>	<b>1,525</b>	<b>1,424</b>



Një tregues i rëndësishëm për rritjen e numrit të raportimeve nga subjektet e ndryshme por edhe për përmirësimin e cilësisë së tyre, sigurohet edhe nga bashkëpunimi dhe efektiviteti i treguar nga DPPP, ndaj:

- informimit të subjekteve në lidhje me tendencat dhe tipologjitë PP/FT;
- mbikqyrjes së subjekteve të bazuar në kategorizimin e riskut;
- fokusi i shtuar punës në kategori subjektsh raportuese që kanë larmishmëri treguesish si dhe mundësi më të zgjeruara për dedektimin e rasteve të dyshimta;
- bashkëpunimin e vazhdueshëm me subjektet raportuese nëpërmjet reagimeve për sasinë dhe cilësinë e raportimit;
- masave administrative të vendosura në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore të subjekteve;
- bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- trajnimeve të realizuara dhe rritjes së ndërgjegjësimit të subjekteve raportuese;

Grafiku 1: Ecuria e raportimeve të RAD për periudhën 2015-2019.



Ecuria e raportimeve të RAD-ve gjatë këtyre viteve interpretohet edhe nëpërmjet grafikut të mësipërm, ku sërish vihet re se pavarësisht rënies së lehtë të raportimeve të disa subjekteve, sistemi bankar vazhdon të jetë një nga treguesit më të rëndësishëm në ndikimin që kanë në sistemin parandalues të PP/FT.

Për vitin 2019, bankat kanë dërguar 651 RAD, ose 15.63% më shumë se ato të dërguara vitin e kaluar, ndërsa shoqëritë e transfertave kanë dërguar 319 RAD, ose 29.15% më shumë se ato të dërguara një vit më parë. Edhe këto të fundit janë ndërgjegjësuar më tepër, në prioritarizimin e transfertave të kryera

në vendet me risk.

Nga RAD e dërguara përgjithësisht vazhdojnë të dominojnë tipologjitë si: blerje të pasurive të paluajtshme/luajtshme me burim të panjohur të fondeve, transfertat e dyshimta, derdhjet e larta në para fizike, dyshime për financim terrorizmi, veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale, përdorimi i llogarisë individuale për qëllime në dukje biznesi/evazion fiskal, dhënie/marrje hua për/nga të tretë, sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga /për të tretë, mosdeklarim i të hollave në kufi etj.

## Analizimi dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit



Analiza e informacionit është një proces kompleks dhe i mbështetur në elementet e indikatorët e detektuar në çdo rast. Baza e të dhënave e përditësuar në vazhdimësi si dhe shembujt më të mirë nga praktikatat ndërkombëtare ndihmojnë këtë proces të evoluojë duke iu përshtatur dinamikës së realitetit si edhe duke qenë të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e qëndrimit në një hap me zhvillimin e shpejtë teknologjik.

Gjatë vitit 2019, iu kushtua rëndësi procesit të analizës:

- Përsa i përket prioritarizimit të raportimeve duke

ju kushtuar rëndësinë e duhur rasteve të plota me elementë të dyshimtë dhe tregues të tjerë që çojnë në një dërgim rastesh më cilësore tek organet ligjzbatuese;

- Vlerësimin të shpejtë për të bërë të mundur bllokimin në kohë të fondeve, për të cilat dyshohej se vinin nga një aktivitet i paligjshëm, në bashkëpunim të ngushtë me organet ligjzbatuese;

Gjatë këtij viti rastet e referuara në organet ligjzbatuese janë paraqitur sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 2: Rastet e referuara në organet e zbatimit të ligjit për periudhën 2015 – 2019.

Referimet	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Referimet në Prokurori	120	120	131	33	25
Referimet në DPPSH	281	291	270	343	241
Total	401	411	401	376	266

Krahas dërgimit të rasteve në Prokurori dhe DPPSH gjatë vitit 2019 ka patur edhe 43 raste të dërguara në DPT të konkluduara me dyshime për evazion fiskal/fshehje të ardhurash apo shkelje të tjera të legjislacionit tatimor.

Përveç dërgimit të rasteve të reja, me rëndësi mbeten edhe informacionet vijuese apo të dhënat

e reja të lidhura me çështje të dërguara më parë, të cilat konfirmojnë dhe thellojnë dyshimet e konstatuara për këto raste.

Ashtu si në 2018 edhe në 2019 pesha më e madhe e rasteve të dërguara i është adresuar DPPSH-së, si organi i specializuar për kryerjen e veprimeve hetimore.

Tabela 3: Informacionet e referuara në DPPSH 2018-2019 dhe ecuria e tyre.

Referimet	Viti 2018	Viti 2019
Referimet në DPPSH nga DPPPP	343	241
Kallëzime nga DPPSH me indicie nga DPPPP	127	190

Ndër rastet e dërguara nga DPPPP, 190 prej tyre kanë shërbyer si indicie për referimet e bëra nga DPPSH për nenin 287 “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të Kodit penal, që përbën një rritje prej 50%, në krahasim me vitin paraardhës.

Për vitin 2019, ka një ndryshim në strategjinë e ndjekur

nga DPPPP, e cila reflektohet edhe në uljen e numrit të rasteve të referuara, konkretisht duke u fokusuar në rastet e plotësuar me dyshime dhe anomali të bazuara, për të cilat jemi thelluar më tepër në analizë me të dhëna të argumentuara financiare.

Kjo strategji është përzgjedhur për të rritur më tepër efektivitetin e ndjekjes së mëtejshme të

rasteve në organet kompetente, me qëllim dhënien e kontributit në plotësimin e detyrave të vendosura për shtetin shqiptar, përsa i përket rritjes së dënimeve penale për PP/FT.

Në uljen e rasteve të referuara nga DPPPP për organet e sipërcituara ka ndikuar edhe rritja e bazave të dhënave në të cilat kemi akses, duke lejuar kështu verifikime më të thelluara të rasteve brenda institucionit.

Për rastet e dërguara në Prokurori mbetet i lartë numri i rasteve të dërguara në Prokurorinë e Tiranës rreth 56%, ndërsa vërehet një shpërndarje e gjerë e rasteve të tjera në Prokuroritë e rretheve Korçë,

Fier, Elbasan, Lezhë , Vlorë, Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë vitit është mbajtur një komunikim i hapur dhe në vazhdim përmes rrugës shkresore me DPPSH, në lidhje me rastet e referuara dhe ecurinë e tyre. Kjo iniciativë ka ndikuar në përmirësimin e rritjen e efektivitetit për trajtimin e informacioneve të referuara nga DPPPP.

Për sa i përket indicjes nga kanë filluar informacionet e dërguara në agjencitë ligj zbatuese, rezulton se burim kryesor i tyre mbeten RAD nga subjektet e ligjit, të cilat kanë shërbyer si pikë nisje për 90% të referimeve.

Tabela 4: Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2019 në DPPSH dhe Prokurori

	RAD	Analiza sektoriale	NjIF Partnere	Njoftime	Totali
Referimet në Prokurori	23	1	-	1	25
Referimet në DPPSH	221	7	7	6	241
Total	244	8	7	7	266

DPPPP i kushton rëndësi edhe identifikimit të mënyrës së veprimit dhe metodave të ndjekura për kryerjen e PP/FT, dhe konkretisht gjatë vitit janë vërejtur kryesisht këto tregues të aktivitetit të dyshimtë:

- investime të larta në pasuri të paluajtshme me burim të panjohur fondesh përgjithësisht kredituar në para fizike;
- investime në mallra luksi nga persona të cilat nuk justifikojnë burimin e fondeve apo persona me precedentë;
- transferta të dyshimta (në mbërritje apo në dalje edhe në tentativë) me përfshirje të subjekteve/ shtetasve të huaj dhe të pajustificuara me dokumentacion mbështetës;
- Sponsorizime/ dhurime/ dhënie huaje nga/ për të tretë pa u konstatuar lidhje të mundshme mes palëve;

- transaksione të pazakonta krahasimisht me profilin financiar të personit/subjektit;
- mashtrime të formave të ndryshme;
- transaksione financiare të kryera nga persona me precedentë të mëparshëm penalë apo persona të lidhur me ata me precedentë;
- mosidentifikimi i përfituesit fundor apo vështirësi në përcaktimin e tij;
- transferta të dyshimta me vende të konsideruara me risk, edhe nga subjekte rishtaz të regjistruara me objekt veprimtarie ‘call center, broker’;

Gjatë analizës së informacionit i është kushtuar vëmendje jo vetëm identifikimit të mekanizmit për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit por edhe identifikimit të burimit të fondeve/pasurisë, veprimtarisë së paligjshme, si dhe lidhjeve të mundshme kriminale të personave/ subjekteve.

Tabela 5: Të dhëna për klasifikimin e veprës së origjinës në periudhën 2015 – 2019

Veprat e Origjinës	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Trafikim të lëndëve narkotike	48	30	43	31	28
Trafikim i qëniveve njerëzore / shfrytëzim prostitucioni	6	7	2	2	5
Krijim/drejtim/ përfshirje në organizata kriminale	6	6	5	3	4
Financim terrorizmi	2	8	5	2	4
Mashtrim, mashtrim financiar, mashtrim kompjuterike	12	17	15	13	18
Falsifikim	8	2	5	2	4
Shpërdorim detyre apo korrupsion kryesisht pasiv	11	9	13	5	10
Mosdeklarim shumave dhe sendeve me vlere në kufi	14	2	1	1	3
Vjedhje, grabitje, kanosje, pasojë vrasje	8	3	7	6	5
Trafikim i mjeteve motorike/ shmangie detyrime doganore/ kontrabandë	2	4	0	0	3
Dyshime për evazion fiskal	41	9	16	5	14
Precedentë të mëparshëm kriminalë	20	12	17	19	17
Nuk dihet	224	302	272	287	151
<b>Total</b>	<b>402</b>	<b>411</b>	<b>401</b>	<b>376</b>	<b>266</b>

Tabela e mësipërme paraqet informacionet e dërguar në organet ligjzbatuese PP dhe DPPSH, për të cilat është arritur të identifikohet vepra e origjinës.

Edhe për vitin 2019, numrin më të lartë të veprimtarive kriminale, për të cilat është bërë i mundur identifikimi i lidhjes me veprën e origjinës,

e zë trafikimi i lëndëve narkotike, mashtrimi, precedentët e mëparshëm kriminalë, shpërdorimi i detyrës, evazoni fiskal/fshehje të ardhurash etj.

Në linjë me vitet e mëparshme, dominojnë rastet për të cilat vepra penale mëmë nuk ka qenë e mundur të përcaktohet. Për këto raste analiza financiare ka konkluduar se:

- fondet e përdorura nuk kanë pasur burime të ligjshme;
- veprimet financiare kanë pasur anomali të dukshme;
- qëllimi ekonomiko-ligjor ka qenë bindshëm i dyshimtë;
- kanë pasur ngjashmëri të theksuara me tipologjitë e njohura ndërkombëtare;



## Urdhrat e bllokimit të përkohshëm

DPPPP ushtron të drejtën e bllokimit të përkohshëm për 72 orë të transaksioneve dhe pasurive të dërguara nga subjektet raportuese, për të parandaluar tjetërsimin e produkteve kriminale apo përdorimin e tyre për financim të terrorizmit në rastet kur ka të dhëna dhe fakte se një gjë e tillë po ndodh apo mund të ndodhë.

Gjatë vitit 2019, janë nxjerrë në total 16 urdhëra bllokimi të përkohshëm, kryesisht për llogari bankare, në një vlerë totale prej rreth 9,7 milion EUR, nga të cilat janë sekuestruar me vendim të Prokurorisë ose Gjykatës, rreth 7,8 milion EUR.

Duke u bazuar në indiciet e dërguara nga DPPPP, në funksion të asetëve të dyshuara me prejardhje kriminale, nga të dhënat e raportuara nga DPPSH, rezulton se janë sekuestruar edhe 940.000 EUR pasuri të paluajtshme, duke e çuar në total vlerën e asetëve të sekuestruara me indicie nga DPPPP rreth 8,7 milion EUR.

Tabela 6: Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet (në EUR) për periudhën 2015 – 2019


Viti	Nr. i urdhrave të bllokimit	Shuma totale e bllokuar	Shuma totale e sekuestruar	Raporti sekuestrime/ bllokime
2015	47	16,278,080	11,266,941	69.20%
2016	61	28,772,733	8,129,000	28.30%
2017	52	11,263,587	9,096,233	80.80%
2018	24	5,428,270	4,536,595	83.60%
2019	16	9,699,690	7,841,091 <sup>1</sup>	80,83%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, vihet re se pavarësisht rënies në numër të urdhrave të bllokimit në krahasim me vitin 2018, konstatohet një rritje në vlerën totale të fondeve të bllokuara dhe të sekuestruara. Në lidhje me raportin e fondeve/pasurive të sekuestruara mbi ato të bllokuara përqindja mbetet konstante mbi 80% për tre vitet e fundit, që përbën një tregues të konsoliduar pozitiv përse i përket efektivitetit të sistemit parandalues.



# TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE


## Tipologji 1: Transferta të kryera nga shtetas me precedentë penal.



Shtetasi 'X', gjatë një periudhe 3- vjeçare ka dërguar një numër të konsiderueshëm transfertash në shtete të ndryshme, kryesisht në drejtim të shtetases shqiptare 'Y', por dhe shtetasve Z1, Z2 (të huaj dhe shqiptarë), pa një lidhje të qartë mes tyre. Transfertat e kryera luhaten në kufijtë: 60 - 6,000 EUR, 15,000 - 110,000 Lek dhe 100 - 200 USD.

Nga verifikime të mëtejshme, ka rezultuar se shtetasi 'X' nuk ka aktivitet tregtar të regjistruar në vendin tonë, ndërsa shtetasja 'Y' është sipërmarrëse në fushën e pasurive të luajtshme/palujtshme'. Për shtetasin 'X' u evidentua se është ish-punonjës i administratës shtetërore në nivel drejtues dhe është arrestuar nga Policia si person i lidhur me trafikun e lëndëve narkotike.

Për sa më sipër, bazuar në numrin e lartë të transfertave brenda dhe jashtë vendit, të kryera nga shtetasit e sipërcituar 'X' dhe 'Y' me shtetas të ndryshëm, lidhjet mes të cilëve janë të paqarta si dhe të dhënat për përfshirjen e shtetasit 'X' në aktivitete të jashtëligjshme, informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.



## Tipologji 2: Transfertë e dyshimtë nga shtetasi i një vendi me risk.

Shtetasi shqiptar 'X' 21 vjeç, rezulton të jetë ortak i vetëm dhe administrator në dy shoqëri të regjistruara: subjektin 'D' Shpk themeluar në vitin 1998, me objekt "Tregtimin e të gjitha mallrave dhe kryesisht të duhanit" dhe subjektin 'E' Shpk të themeluar në vitin 2019, me objekt në fushën e ndërtimit dhe punime të infrastrukturës.

Gjatë vitit 2019, ky shtetas ka përfituar në llogarinë personale në monedhën EUR, një transfertë ndërkombëtare nga një vend i Lindjes së Mesme '@', në shumën 300,000 EUR nga dërgues shtetasin 'Y' (mosha 45 vjeç) - shtetas i një vendi tjetër me risk të Lindjes së Mesme 'β' dhe banues në shtetin nga ku është dërguar transferta. Qëllimi i deklaruar i transfertës është financimi i shoqërisë 'E' Shpk, bazuar në një kontratë huaje 1-vjeçare, të nënshkruar një ditë pas themelimit të kompanisë 'E' Shpk. Në kontratë është parashikuar që në rast moskthimi të huasë brenda vitit 2019, shtetasit 'Y' i lind e drejta të përfitojë 49% të aksioneve të shoqërisë.

Anomalitë në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në:

- Lidhja e kontratës midis shtetasve, ndërkohë që qëllimi i lidhjes së saj deklarohet si "për investime të kryera në shoqërinë e sapothemeluar 'E' Shpk, të nënshkruar një ditë më vonë nga data e themelimit të shoqërisë 'E' Shpk.
- Paqartësi për lidhjen mes shtetasve dhe dhënien e një huaje të konsiderueshme.
- Paqartësi mbi motivet pse shtetasi 'X', për kryerjen e investimeve për biznesin e ri, kërkon hua nga një shtetas i vendit 'β', ndërkohë që ka fonde të mjaftueshme të tij në vlerën 555 milion Lek (kapitali) nga shoqëria tjetër e tij 'D' Shpk.
- Kushti i vendosur në rast moskthimi të huasë, mund të çënojë barazinë e palëve e themeluar rishtazi.

Nga kërkimet në burime të hapura, rezultuan të dhëna se bashkëpunimi midis dy shtetasve 'X' dhe 'Y' shtrihej në fushën e prodhimit dhe eksportimit të cigareve. Shoqëria 'D' ka pasur një kontratë për prodhimin e cigareve për subjektin 'F' Shpk, subjekt i zotëruar nga shtetasi Y. Subjekti 'F' Shpk është themeluar në një nga vendet e konsideruara parajsë fiskale, kryen investime në fushën e cigareve dhe duhanit, transportit, naftës, gazit, e telekomunikacionit dhe është akuzuar për kryerje kontrabande në tregtimin e cigareve në disa shtete të ndryshme.

**Bazuar në:**


- Dyshimet për burimin e të ardhurave të shtetasit të huaj, të cilat duken të prejardhura nga aktivitete të jashtëligjshëm.
- Financimin e biznesit të ri në fushën e ndërtimit,

fushë e njohur për përdorimin edhe për pastrim parash, nëpërmjet fondeve të krijuara në rrugë të paligjshme si dhe futja e tyre në sistemin financiar me qëllim ligjërimit e tyre duke iu drejtuar një pale të tretë, konkretisht shtetasit të huaj i cili dyshohet për ushtrimin e aktiviteteve të paligjshme dhe krijimin e fondeve jo të ligjshme nga këto aktivitete,

- kushtet e pazakonta të deklaruar në kontratën e huadhënies, jo të atilla që të justifikojnë shlyerjen potenciale të kësaj huaje.
- dyshimet se shtetasi 'X' mund të mos jetë *de facto* zotëruesi i këtyre bizneseve.

dyshohet se kemi të bëjmë me një skemë të pastrimit të parave e realizuar nëpërmjet krijimit të kompanive me kapital minimal dhe pastaj shitja e aksioneve në vlera më të larta. Informacioni është referuar në organet e zbatimit të ligjit.

Skema 2:



## Tipologji 3: Transferta të dyshimta të përfituara nga kryerja e një aktiviteti ekonomik fiktiv

Gjatë muajit prill 2019 shtetasi 'X' ka regjistruar në QKB shoqëritë tregtare 'A' Shpk dhe 'B' Shpk . Të dyja shoqëritë e sipërpërmenduar kanë si ortak dhe administrator të vetëm shtetasin 'X' (shtetas i huaj nga një vend i BE-së) dhe objekt veprimtarie të njëjtë në fushën e konsulencës financiare dhe hulumtime të tregut. Është kërkuar informacion nga subjektet e ligjit dhe nga analizimi i të dhënave bankare lidhur me dy shoqëritë tregtare ka rezultuar se:

- Nga momenti i regjistrimit të tyre në QKB e në vijim shoqëritë kanë përfituar transferta të shpeshta në vlera që variojnë nga 985 Euro në 15,927 USD me përshkrimin "Konsultim financiar";
- Dërgues të këtyre fondeve janë shtetas nga më shumë se dhjetë shtete të ndryshme përfshirë dhe ato të BE-së;
- Vlerat e përfituara tërhiqen nga shtetasi 'X' dhe vetëm shuma 14,000 Euro transferohet në një vend të BE-së në favor të shoqërisë 'C', e themeluar në një vend të njohur si parajsë fiskale.


Subjektet tregtare nuk kanë kryer aktivitet të mirëfilltë ekonomik, bazuar edhe në deklaratimet e kryera në institucionet përkatëse.

Në tetor të vitit 2019 pranë bankës 'Z', ka mbërritur një mesazh SWIFT nga banka korespondente 'V', nëpërmjet të cilit jepet informacion se klienti i tyre, shtetasi 'M' ka depozituar në policinë e një shteti tjetër (vend jo i BE-së), një kallzim për mashtrim në lidhje me një transfertë të realizuar prej tij drejt shoqërisë 'A', në shumën rreth 1,000 USD. Po kështu në tetor 2019 shoqëria 'A' ka përfituar dy transferta në vlerën totale rreth 2,000 EUR pranë bankës 'Z' me dërgues shtetasin 'L' (vend jo i BE-së), me përshkrimin "Konsultim financiar" dhe më pas shtetasi urdhëruar ka kërkuar kthimin e fondeve, me pretendimin se ky i fundit ishte përfshirë në një investim

mashtrues nga ana e shoqërisë 'B'.

Duke marrë në konsideratë:

- pretendimet për mashtrim nga shtetas dërgues të fondeve lidhur me subjektet e administruar nga shtetasi 'X';
- shtetasi 'X' ka themeluar dy subjekte tregtare me të njëjtin objekt aktiviteti, të cilat kanë përfituar transferta në vlera të konsiderueshme në një kohë relativisht të shkurtër;



Skema 3:

- transfertat e përfituara janë të të njëjtës tipologji (Konsultim financiar) dhe dërgesat kryhen nga subjekte dhe vende të ndryshme, pa një lidhje të dukshme ndërmjet tyre;
- një pjesë e fondeve të përfituara, transferohen nga llogaritë bankare të subjekteve 'A' Shpk dhe 'B' Shpk drejt një vendi të BE-së, për llogari të shoqërisë 'C' të themeluar në një vend parajsë fiskale; informacioni është konsideruar me anomali dhe për rrjedhojë i është dërguar për investigim të mëtejshëm organeve të zbatimit të ligjit.

## Tipologji 4: Transferta të larta në mbërritje në favor të shoqërive Call Center.

Në periudhën janar 2019-gusht 2019, pranë Bankës 'X', ka patur transferta të larta në mbërritje në favor të disa shoqërive të llojit *Call Center*, fonde të cilat më pas tërhiqeshin menjëherë nga persona të autorizuar të këtyre shoqërive.

Shtetasit 'A' dhe 'B', të cilët shfaqeshin si persona të autorizuar në veprimtaritë ekonomike të cilat në dukje nuk kishin asnjë lidhje ndërmjet tyre, rezultuan të njohur midis tyre.

Gjatë analizimit të thelluar të rastit, u vu re se rreth 16 veprimtari të llojit "Call Center" me të njëjtin objekt aktiviteti ishin themeluar brenda dy ditëve. Ortakë të këtyre shoqërive ishin shtetas të ndryshëm nga një vend i BE-së, përkatësisht shtetasit D,E,K,L dhe M.


Pas verifikimit të hyrje-daljeve të tyre në Shqipëri, rezultoi se këta shtetas kanë hyrje-dalje në data të përbashkëta, që i paraprijnë krijimit të shoqërive.

Duke marrë në konsideratë:

- Transferta në mbërritje, të pasuara me terheqjet në mënyrë të menjëhershme, nga shtetas shqiptarë të njohur ndërmjet tyre;
- Shoqëri të krijuara me të njëjtin objekt veprimtarie, të themeluara nga shtetas të ndryshëm të huaj nga i njëjti vend i BE-së, të cilët kanë udhëtuar në të njëjtat data;

Rasti është konsideruar me anomali, për rrjedhojë informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm organeve të zbatimit të ligjit.

Skema 4:





## Tipologji 5: Transfertë e dyshimtë në mbërritje nga një shtetas i një vendi me risk në Lindjen e Mesme

Në Mars të vitit 2019, pranë bankës 'Z', ka mbërritur një transfertë në vlerë 50,000 Lek me përfitues shtetasen shqiptare 'X'. Transferta urdhërohet nga një shtetasi 'A', me vendlindje në një shtet të Lindjes së Mesme, dhe me vendqëndrim në një shtet të BE-së. Kjo transfertë urdhërohet nga një vend jo i BE-së.

Përfituesja e fondeve 'X' shprehet se kjo shumë dërgohej me qëllim "ndihmesën në zhvillimin e një veprimtarie ekonomike në Shqipëri". Fondet ishin në vlerë jo të lartë dhe kjo krijoi dyshime për qëllimin e transfertës, që mund të ishte testimi i sistemit për mbërritjen e fondeve në destinacion, ndërkohë që me një shumë të tillë nuk është e pritshme që të

arrihet qëllimi i deklaruar.


Nga verifikimet e kryera nga institucioni financiar, në të dhënat e *World Check*, rezultoi një përputhje e gjeneraliteteve të emrit dhe mbiemrit të shtetasit 'A' dhe të vendlindjes së tij, si person i dyshuar për përfshirje në grupe militante/terroriste.

Duke marrë në konsideratë:

- Transfertën e dërguar nga një vend jo i BE-së, nga një shtetas i një vendi me risk në Lindjen e Mesme dhe me vendqëndrim në një shtet të BE-së;
- Përshkrimi i dyshimtë i transfertës në mbërritje në lidhje me qëllimin e dërgimit;
- Mungesa e një lidhjeje ndërmjet palëve;
- Indicia për një përputhje me gjeneralitetet e dëguesit me një person të dyshuar për përfshirje në grupe militante/terroriste;

rasti është konsideruar i dyshimtë, për rrjedhojë është dërguar informacion për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit brenda vendit, si dhe është dërguar informacion spontan në vendin origjinues të transfertës.

Skema 5:





## ANALIZA STRATEGJIKE

Veprimtaria e analizës strategjike, ka konsistuar kryesisht në rishikimin e vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT, por edhe në kryerjen e analizave sektoriale të tilla si: huatë informale, analizë në lidhje me raportimet e shoqërive të transfertave, në bazë të cilave janë trajtuar dhe dërguar informacione për aktivitetet të dyshimtë në organet ligjzbatuese.

Bazuar në rekomandimet e FATF-së, konkretisht Rekomandimi nr. 1, i cili detyron shtetet të kryejnë vlerësime kombëtare risku, por edhe nga detyrimi i shprehur në ligj, analiza strategjike gjatë vitit 2019 është angazhuar në mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave në funksion të kryerjes së një vlerësimi të përditësuar, duke marrë në konsideratë edhe eksperiencën e krijuar dhe praktikatat më të reja.

Dokumenti i Vlerësimit Kombëtar të Riskut,

përbën versionin e dytë të rishikimit të riskut PP/FT nga autoritetet shqiptare dhe është rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë ndërinstitucional dhe konsultimi me një sërë aktorësh publik dhe privat, me anë të të cilit synohet të sigurohet një njohje më e mirë e risqeve PP/FT, një qasje efektive në drejtim të parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre aktiviteteve kriminale dhe personave të përfshirë.

Dokumenti i vlerësimit të riskut i është dërguar Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, të gjitha institucioneve përkatëse në vend, organeve mbikëqyrëse, subjekteve financiare e më tej në bazë të konkluzioneve të tij, është miratuar një plan veprimi për marrjen e masave për risqet kryesore të identifikuara.

# NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË

## Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese

Në funksion të përmbushjes efektive të detyrimeve ligjore, DPPPP i ka kushtuar në vijimësi vëmendje të posaçme procesit të ndërgjegjësimit dhe trajnimit të subjekteve. Në këtë drejtim gjatë vitit 2019, janë realizuar një sërë takimesh dhe trajnimesh me subjektet e ligjit në të cilët janë trajtuar çështjet që lidhen me adresimin e rekomandimeve të Komiteti Moneyval të KiE dhe institucioneve të tjera monitoruese, zbatimin e masave të vigjilencës së thjeshtuar, së duhur dhe të zgjeruar me klientët, profili i riskut dhe kategoritë e klientëve me risk të lartë për PP/FT, analizimi dhe raportimi i transaksioneve komplekse, njohja me ndryshimet më të fundit në bazën ligjore për parandalimin e PP/FT, zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur në zbatim të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, tipologji PP/FT në nivel

kombëtar dhe ndërkombëtare.

Krahas organizimit të seanceve individuale të trajnimit, DPPPP ka vijuar bashkëpunimin dhe me autoritete mbikëqyrëse dhe licencuese, me qëllim që të prezantohet sa më mirë përvoja parandaluese e institucioneve si dhe të vlerësohet niveli i përputhshmërisë së subjekteve me legjislacionin PP/FT.

Nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit, është synuar që efekti i tyre të shtrihet në një gamë sa më të gjërë të subjekteve, veçanërisht në ato që kategorizohen me risk të mesëm dhe të lartë.

Në tabelën vijuese, paraqiten të dhënat periodike, në lidhje me numrin e personave të trajnuar sipas subjekteve të ligjit.

Tabela 7: Numri i personave të trajnuar në subjekte për periudhën 2015 – 2019.

Subjekti	Nr. i personave të trajnuar				
	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Banka	285	108	364	203	208
ZKV/dhe ose agentë të transferimit të parave	73	77	35	73	267
Shoqëri transfertash					6
Institucione jo-bankë	115	188	115	126	7
Shoqëri ndërmjetësimi	0	0	0	3	0
Lojëra Fati	0	6	3	1	0
Noterë/avokat	73	127	30	221	72
Auditues ligjor	0	1	3	2	114
Shoqëri të sigurimit të jetës dhe shoqëri komisionere	35	1	1	2	35
Autoritete Mbikëqyrëse dhe Institucione (AMF, ASHK, DPPSH, DPD, DPT)	58	108	27	24	20
Shoqëri tregtimi të automjeteve	0	3	3	0	10
OJF	45	0	0	0	48
Shoqëri ndërtimi	0	8	14	18	13
Shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit	5	1	1	0	8
Agjentë të pasurive të paluajtshme				29	0
<b>Totali</b>	<b>689</b>	<b>628</b>	<b>596</b>	<b>702</b>	<b>808</b>



Gjatë vitit 2019, prioritare në numrin e personave të trajnuar kanë qenë subjektet financiare bankare, zyrat e këmbimit valutor të cilat veprojnë dhe si agentë të transferimit të parave, audituesit ligjorë dhe noterët. Tematikat kryesore të diskutuara në këto trajnime kanë qenë:

- intensifikimi i analizimit të transaksioneve dhe aktivitetit të klientëve të konsideruar me risk të lartë;
- rritja e vëmendjes për transaksionet me para në dorë dhe atyre jashtë profilin ekonomik të klientit;
- masat kundër financimit të terrorizmit, sanksionet ndërkombëtare për personat e shpallur si terrorist;
- hartimi/rishikimi i vlerësimeve të riskut nga subjektet raportuese dhe masat për adresimin e risqeve të evidentuar në dokumentin e Vlerësimit Kombëtar të Riskut;
- përditësimi i vazhdueshëm i njohurive në bazë të tipologjive rajonale dhe më gjerë;
- rritja e mëtejshme e fokusit në funksion të detektimit të rasteve të dyshimta dhe specializimit nga strukturat në nivel bazë/lokal të subjekteve financiare;

Në këto takime një rëndësi e veçantë i është

kushtuar kryesisht autoriteteve të cilat licencojnë dhe mbikëqyrin subjektet e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” duke i informuar mbi rastet problematike, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për rolin që kryejnë dhe nevojën e bashkëpunimit për forcimin e sistemit parandalues në vend.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan gjithashtu dhe inspektimi në vend i subjekteve nga ana e DPPPP, i cili krahas kontrollit për zbatimin e detyrimeve ligjore, ofron dhe ndihmesë për përfaqësuesit e subjekteve në drejtim të zbatimit të ligjit në vijimësi, duke e konkretizuar atë dhe me rastet praktike të punës së tyre.

Përpos takimeve, trajnimeve apo inspektimeve në vend, në komunikimin me subjektet e ligjit DPPPP ka përdorur gjerësisht dhe mjetet elektronike për të dhënë udhëzime apo paraqitur tipologji të PP/FT, për kategori të caktuara të subjekteve.

Duke marrë në konsideratë praktikatat e shteteve të tjera dhe vëmendjen e tyre në rritje ndaj OJF-ve, si dhe duke vlerësuar riskun që këto organizata kanë ndaj Financimit të Terrorizmit gjatë vitit 2019, nga DPPPP janë organizuar disa trajnime në bashkëpunim me DPT, si autoriteti që regjistron dhe mbikëqyr veprimtaritë e OJF-ve.

## Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë

Përputhshmëria e subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e PP/FT, përbën një nga objektivat kryesorë të veprimtarisë së DPPPP. Për të siguruar një nivel në rritje të efektivitetit të procesit të mbikëqyrjen së përputhshmërisë, puna e drejtorisë është përqendruar në ato kategori subjektsh, të cilat paraqesin një nivel të mesëm apo të lartë të riskut, ndaj pastrimit të produkteve të veprave penale.

DPPPP gjatë vitit 2019, ka vijuar aktivitetin e saj për orientimin e punës parandaluese të subjekteve të ligjit, veçanërisht të institucioneve financiare drejt vlerësimit individual të riskut për PP/FT, në të cilën theksi është vënë në faktorët që kanë të bëjnë me rrezikun e klientit,

shërbimeve dhe produkteve të ofruara, rrezikun gjeografik dhe treguesit e financimit të terrorizmit, për të forcuar dhe konsoliduar më tej strukturat e tyre parandaluese.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, ka qenë një nga shtyllat kryesore dhe për këtë qëllim janë realizuar një sërë inspektimesh të përbashkëta në subjektet financiare në bashkëpunim me BSH, në shoqëritë e sigurimit të jetës, agjentë-broker dhe pranë Depozitarit të Fondeve të Investimeve së bashku me AMF.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për inspektimet në vend dhe në distancë të vitit 2019, të krahasuara me periudhat pararendëse.

Tabela 8: Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2016-2019.

Nr.	Subjektet e Inspektuara	Viti 2016		Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019	
		Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
1	Banka	9		5	2	7	7	5	
2	IFJB	9		5		7		3	9
3	Shoqëri ndërmjetësimi			1		3			
4	ZKV	12	1	18	27	19	20	16	25
5	Ekspertë kontabël	1	1	3	9	2	11	10	3
6	Shoqëri ndërtimi	8	14	14	19	9	14	13	27
7	Mjete motorike	3	1		5				5
8	Noterë	21	28	6	17	10	39	11	20
9	Lojëra fati	6		3	3	1			
10	Shoqëri të sigurimit të jetës dhe ri-sigurimit	1		1		2			
11	Studio ligjore				15	3			4
12	Shoqëri administrimi & tregtimi të letrave me vlerë								
13	Shoqëri të kursim kreditit	2		1					5
14	Shoqëri transporti								
15	Vepra arti								
16	Metale të çmuara			1					
17	Agjensi të pasurive të paluejtshme	4		3	5		19	1	8
18	Fonde Investimi/Pensioni/Depozitarë	1		1		1		3	
19	Agjenci udhëtimi			1	6		8		8
	Shuma	77	45	63	108	64	118	62	114
	<b>TOTALI</b>		<b>122</b>		<b>171</b>		<b>182</b>		<b>176</b>





Për vitin 2019, janë inspektuar në total 176 subjekte, prej të cilave 65% kanë qenë inspektime në distancë. Puna e DPPPP është orientuar drejt riskut të PP/FT dhe në këtë kontekst 73% e totalit të inspektimeve të realizuara janë përqendruar në subjektet me risk të lartë (Banka 5, ZKV 41, IFJB 12, shoqëri ndërtimi 40 dhe noterë 31).

Gjatë procesit të analizës së përputhshmërisë për vitin 2019, vërehet një përmirësim i përputhshmërisë të subjekteve raportuese me detyrimet ligjore. Thuajse 1 në 10 inspektime gjatë këtij viti ka rezultuar me masë administrative, kundrejt 1 në 7 në vitin 2017 dhe 1 në 4 gjatë viteve 2013-2016. Mangësitë kryesore të evidentuara kanë qenë:

- mos raportimi i transaksioneve të kryera në

para fizike mbi pragun e përcaktuar në ligj, megjithëse rastet janë sporadike dhe në ulje;

- nuk është kryer monitorim i duhur i marrëdhënies së biznesit me klientin;
- nuk është mbajtur një sistem i përshtatshëm i centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave;
- mos kryerja e analizave të thelluara për transaksionet komplekse, në vlera të larta, të pazakonta dhe të pa justifikuara nga pikëpamja ekonomike;

Për këto mangësi, DPPPP ka vijuar procesin e shqyrtimit të shkeljeve të evidentuara, si dhe ka bërë rekomandimet për subjektet dhe njëkohësisht ka vënë në dijeni autoritetet mbikëqyrëse.

# MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE

## Masat administrative

Gjatë vitit 2019, janë evidentuar subjekte që nuk përmbushin nivelin e duhur të përputhshmërisë me kuadrin rregullator për parandalimin PP/FT, për të cilat ka vijuar procesi i shqyrtimit të kundërvajtjes administrative deri në dhënien e dënimit me gjobë sipas dispozitave përkatëse. Përveç inspektimeve në vend, janë vlerësuar dhe praktika të mbikëqyrjes në distancë nëpërmjet Raporteve të Vetëkontrollit apo indicieve nga monitorimi në distancë i subjekteve për shkelje të detyrimeve ligjore.

Minimumi i gjobës së aplikuar ka qenë 300,000 Lek dhe maksimumi 800,000 Lek. Vlera totale e gjobave të vendosura është 5,7 milion Lek.

Peshën kryesore nga subjektet e gjobitura e zënë shoqëritë e ndërtimit ndaj të cilave janë aplikuar 5 masa me vlerë 3 milion Lek, të ndjekura nga noterët,

ndaj të cilave u aplikuan 2 masa me vlerë totale 1,1 milion Lek.

Masat administrative të vendosura në raport me inspektimet e kryera kanë pësuar ulje, element ky përgjithësisht tregues i rritjes së masave të sistemit parandalues në vend, ndërgjegjësimit si dhe efikasitetit të reagimit ndaj sfidave të përbashkëta.

Nga shqyrtimi i praktikave të inspektimit dhe mbikëqyrja në distancë është konkluduar dhe janë vendosur 10 masa administrative. Kundërvajtjet administrative për subjektet e ligjit konsistojnë në shkelje të kategorizuara në grupime si më poshtë:

- Mos raportim të transaksioneve mbi pragun;
- Moszbatim të detyrimit për kryerjen e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar;



Tabela 9: Numri dhe vlera e masave administrative (në Lek) sipas llojit të subjekteve për periudhën 2015- 2019.

Subjekte	2015		2016		2017		2018		2019	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Banka	2	6,000,000	5	10,700,000	5	17,000,000	0	0	0	0
ZKV	8	6,800,000	5	3,500,000	8	3,600,000	3	1,100,000	1	500,000
Noterë	4	2,700,000	11	3,400,000	2	1,000,000	4	2,800,000	2	1,100,000
IFJB	3	2,200,000	2	1,000,000	1	500,000	0	0	1	500,000
Lojëra fati	0	0	4	3,600,000	1	500,000	0	0	0	0
Shoqëri ndërtimi	15	14,700,000	4	3,800,000	9	6,000,000	10	9,800,000	5	3,000,000
Agjenci udhëtimi	1	300,000	0	0	0	0	0	0	0	0
Shoqëri të sigurimit të jetës	1	2,000,000	0	0	0	0	0	0	0	0
Shoqëri të tregimit të mjeteve motorike	0	0	2	4,000,000	0	0	1	500,000	1	600,000
<b>TOTALI</b>	<b>34</b>	<b>34,700,000</b>	<b>33</b>	<b>30,100,000</b>	<b>26</b>	<b>28,600,000</b>	<b>18</b>	<b>14,200,000</b>	<b>10</b>	<b>5,700,000</b>



## Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore

Gjatë vitit 2019, janë arkëtuar në total 5,018 milion Lek nga të cilat 1,9 milion Lek janë arkëtime nga masat administrative të vendosura në vitet e mëparshme, ndërsa 3,118 milion Lek lidhen me masa të vendosura këtë vit.

Tabela 10: Të dhëna për arkëtimet për periudhën 2015- 2019

Zërat	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Masa administrative	34	33	26	18	10
Shuma totale e masave LEK	34,700,000	30,100,000	28,600,000	14,200,000	5,700,000
Shuma totale e arkëtimit LEK	17,656,000	31,786,000	27,788,000	22,590,643	5,018,000

Nga masat administrative të vendosura gjatë këtij viti, 5 (pesë) prej tyre janë arkëtuar, kurse pjesa tjetër janë në proces.

Për të rritur efikasitetin e ekzekutimit të masave administrative, DPPP ka ndjekur me vëmendje fazat e ekzekutimit me zyrat përmbarimore, duke rritur në këtë mënyrë dhe efikasitetin e kësaj veprimtarie, deri në përmbyshjen e fazave të ekzekutimit të detyrueshëm.

DPPP i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndjekjes së proceseve gjyqësore në lidhje me masat administrative të vendosura, nga ku çështje gjyqësore të përfunduara gjatë këtij viti janë:

- Është dalë me vendime në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për 11 çështje, të cilat në masën 81.8 %, janë dhëne në favor të DPPP.
- Janë shpallur vendime në Gjykatën Administrative të Apelit për 11 çështje, të cilat në masën 81.8 %, janë dhënë në favor të DPPP (ku spikasin dy vendime të dhëna në favor të subjekteve në Shkallë të Parë).

Gjithashtu janë analizuar praktikat gjyqësore në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të procedimit administrativ, si dhe të unifikimit të praktikave për zbatimin nga subjektet të legjislacionit për parandalimin e PP/FT.



# BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR


## Bashkëpunimi kombëtar ndër-institucional

Përkushtim dhe angazhim maksimal është treguar përsa i përket koordinimit dhe bashkëveprimit ndër-institucional me institucione të tjera brenda vendit, jo vetëm në rolin e DPPPP si koordinatore e procesit të vlerësimit nga Komiteti Moneyval por edhe në kuadër të bashkëpunimit për çështjet e parandalimit të PP/FT.

Gjatë vitit 2019, është theksuar përmes korrespondencës të vazhdueshme me DPPSH dhe Prokuroritë e ndryshme, nevoja për shkëmbim informacioni dhe reagimin në kohë dhe efektiv për rastet nën apo procedim, veçanërisht për informacionet e referuara nga DPPPP.

Konkretisht për këtë vit kemi trajtuar 186 kërkesa të dërguara nga DPPSH, në të cilat është kërkuar informacion për 1,293 persona, për të cilat është kthyer përgjigje. Nga prokurori të ndryshme, janë dërguar 151 kërkesa në të cilat janë kërkuar të dhëna për 1,060 persona për të cilët DPPPP ka kryer verifikime shpesh edhe në subjektet e ligjit dhe ka informuar në kohë prokuroritë.

Grafiku 2: Numri i kërkesave për verifikime dhe numri i personave të përfshirë.








Ka vijuar bashkëpunimi i posaçëm me Task Forcën “Forca e Ligjit” nëpërmjet përfaqësuesit të DPPPP, duke reaguar shpejt sidomos për kërkesat e konsideruara me prioritet nga Task Force.

Bashkëveprimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese ka qenë në vëmendje të institucionit përsa i përket trajnimeve dhe inspektimeve të përbashkëta në subjektet e ligjit me qëllim rritjen e cilësisë së kontrolleve dhe auditimeve nga të gjitha palët e përfshira.

Pjesë e rëndësishme e punës së DPPPP, e cila kërkon angazhim të gjerë të punonjësve të institucionit, ka qenë edhe bashkëpunimi me institucione ekzistuese apo krijuara rishtazi me ligj, me të cilat kemi shkëmbyer informacion në kuadër të kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave të tyre si: KJV, KPK, ILDKPKI, BSH, DSIK dhe AMF. Gjatë vitit 2019 kemi kryer verifikime për rreth 1,484 persona në kuadër të 395 kërkesave të ardhura nga institucione të ndryshme brenda vendit.

Grafiku 3: Numri i kërkesave për verifikime dhe numri i personave të përfshirë në to.



Evidentojmë si të rëndësishëm bashkëpunimin me SHISH si një institucion partner dhe strategjik në luftën e përbashkët kundër kriminalitetit. DPPPP ruan një marrëdhënie konstante komunikimi me këtë institucion.

DPPPP në varësi të rezultateve të analizave financiare, përsa i përket rasteve të konkluduara me dyshime për evazion fiskal apo shkelje të tjera të mundshme të kësaj fushe, ka informuar DPT për 43 raste. Bashkëpunimi ka qenë i ngushtë edhe përsa i përket riskut të sektorit të OJF-ve për të cilin është kryer një analizë specifike gjatë vitit 2019 e cila do të orientojë punën e mbikëqyrjes në bazë risku.

## Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit rajonal, në tetor 2019 u organizua në Ohër të Maqedonisë së Veriut, takimi vjetor i NjIF të rajonit, në të cilin merrnin pjesë përfaqësues të NjIF nga Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Sllovenia dhe Shqipëria. Gjatë këtij takimi janë diskutuar dhe shkëmbyer eksperiencat për sa i përket tipologjive dhe tendencave rajonale, eksperiencat e vendeve nga vlerësimet e bëra nga Komiteti Moneyval i KiE, zbatimi i direktivave të BE-së në fushën e parandalimit të PP/FT, pjesëmarrja në takimet e grupit Egmont të NjIF.

DPPPP gjatë vitit 2019, është angazhuar rregullisht në punën të Grupit Egmont të NjIF, duke marrë pjesë në projektet e ndryshme për të cilat është kërkuar bashkëpunim por edhe në mbledhjen plenare të këtij grupi të realizuar në Korrik 2019 në Hagë, Holandë.


Në shtator dhe tetor 2019, u zhvilluan edhe dy vizita pune e nivelit të lartë në NjIF e Greqisë dhe të Mbretërisë së Bashkuar, ku u diskutuan çështje të bashkëpunimit dypalësh në kuadër të luftës kundër PP/FT. Me rëndësi ishte nënshkrimi i marrëveshjes së ripërtërirë të bashkëpunimit mes dy institucioneve: NjIF Greqi dhe NjIF Shqipëri.



## Shkëmbimi i informacioneve me NjIF

Gjatë vitit 2019 kemi shkëmbyer informacion me NjIF partnere detajuar si më poshtë:

Grafiku 4: Shkëmbimi i informacionit me NjIF.





## Procesi i vlerësimit nga komiteti Moneyval i KiE

Gjatë vitit 2019, vendi ynë ka qenë në proces monitorimi të përfunduar nga Komitetit Moneyval, si dhe njëkohësisht në një periudhë monitorimi nga ICRG (pjesë e FATF). Dy proceset e vlerësimit/monitorimit, ai i Moneyval dhe ICRG, janë të ndërthurur me njëri tjetrin, por edhe të pavarur mes tyre.

Gjatë seancës së 59-të plenare të komitetit Moneyval të mbajtur në dhjetor 2019, u miratua raporti i parë i monitorimit për Shqipërinë, me anë të së cilit shqyrtohej përputhshmëria teknike dhe në sajë të masave të marra u siguroi rritje e vlerësimit për 6 Rekomandime të FATF<sup>1</sup>. Në këtë takim delegacioni Shqiptar nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPPP, kishte në përbërje përfaqësues nga Prokuroria, DPPSH, DPPP, BSH, AMF dhe QKB.

Për pjesën e efektivitetit të sistemit shqiptar të parandalimit PP/FT, raportimi është kryer në grupin e punës të ICRG/FATF në periudhën nëntor-dhjetor 2019 dhe do të vijojë gjatë vitit 2020.

1. Konkretisht Rekomandimet 8, 18 dhe 35, të vlerësuar fillimisht si PC (partially compliant), rivlerësohen si LC (largely compliant). Rekomandimet 6 dhe 19, të vlerësuara fillimisht si PC, rivlerësohen si C (compliant). Rekomandimi 21 fillimisht i vlerësuar si LC, rivlerësohet si C.



# BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI

## Buxheti dhe menaxhimi i tij

Gjatë vitit 2019, DPPPP ka shpenzuar në total 81.56 milionë lekë, ose 17% më shumë krahasuar me vitin 2018. Realizimi i shpenzimeve rezultoi në masën 91% të fondit të planifikuar.


Shpenzimet ishin të ndara në 55,7 milionë lekë shpenzime korrente dhe 25.9 milionë lekë shpenzime kapitale. Raporti i shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, ndaj totalit rezultoi respektivisht 68% dhe 32%. Krahasuar me vitin 2018, kur struktura e shpenzimeve ishte 76% korrente dhe 24% kapitale, vërehet rritje e peshës relative të shpenzimeve kapitale ndaj totalit, si pasojë e rritjes

së investimeve, kryesisht në infrastrukturën e TI.

Shpenzimet korrente u rritën me 5.5% krahasuar me një vit më parë. Ato u realizuan në masën 89% të planit. Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e realizimit të ulët të zërit “Mallra dhe shërbime të tjera”, por pa çenuar shërbimet kryesore të tilla si shërbimet e mirëmbajtjes dhe sigurisë së infrastrukturës së TI.


Shpenzimet kapitale, shënuan një nivel të lartë, duke rezultuar 1.5 herë më të larta krahasuar me vitin 2018 dhe 10 herë më të larta se në 2017. Realizimi i tyre, kundrejt planit final për 2019 ishte 96%.

Grafiku 5: Fondet buxhetore në dispozicion dhe përdorimi i tyre në vite.






Grafiku 6: Shpenzime korrente në dispozicion dhe përdorimi i tyre në vite:



Grafiku 7: Shpenzime kapitale (investime) në dispozicion dhe përdorimi i tyre në vite:



DPPPP do vijojë të jetë e angazhuar në menaxhimin aktiv të buxhetit, transparencën dhe përmirësimin e procesit të planifikimit, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës së TI, duke mundur zbatimin dhe arritjen e objektivave institucionale, në luftën kundër PP/FT.

## Menaxhimi i burimeve njerëzore

Gjatë 2019, struktura organizative e DPPP është rritur me 6 punonjës duke shkuar në një total prej 45 punonjësish dhe ka pasur një realizim mesatar prej 80%. Për këtë periudhë, në bashkëpunim me strukturat e Departamentit të Administratës Publike, janë realizuar procedurat e ristrukturimit në nëntor 2019 dhe janë nisur procedurat e rekrutimit për plotësimin e 10 vendeve vakante të krijuara nga largimet me dëshirë gjatë vitit si dhe nga shtesat në strukturë, në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij. Nga këto pozicione vakante, 6 kanë qenë rekrutime në nivel ekzekutiv, dhe 4 pozicione në nivel drejtues.

Nëpërmjet strukturës përgjegjëse, janë mbikëqyrur dhe administruar burimet njerëzore, në zbatim të parimeve dhe kriterëve të legjisllacioni në këtë fushë, si dhe janë kryer proceset e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve, në përputhje me afatet ligjore.

DPPP ka mundësuar rritjen profesionale të stafit dhe përfitimit të njohurive të reja në fushën e parandalimit të PP/FT, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga KiE, UNODC dhe OSBE.

Gjatë 2019, 30 punonjës të DPPP kanë qenë pjesëmarrës në 43 trajnime, ku temat kryesore që janë trajtuar kanë qenë: “Teknikat e hetimit financiar”, “Gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve”, “Udhëzime dhe indikator për parandalimin e krimit kibernetik”, “Metodat dhe teknikat analitike për investigimin e PP/FT”




dhe “Trafikimi i qenieve njerëzore”.

DPPP, në kuadër edhe të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për arritjen e objektivave në luftën kundër PP/FT, do të vazhdojë të ndjekë politika prioritare për përmirësimin e kapaciteteve profesionale, të bazuara jo vetëm në rritjen në numër të strukturës organizative por dhe në rritjen profesionale të stafit nëpërmjet ofrimit të mundësive dhe përfshirjes në trajnime.





Organigrama e DPPP:





## Teknologjia e informacionit

Rritja e kapaciteteve të TI, ka vijuar të jetë një nga aspektet prioritare të punës së DPPPP gjatë vitit 2019. Investimet e realizuara në DPPPP, kanë qenë të fokusuara në përmirësimin e infrastrukturës dhe sistemeve të TI në DPPPP, ecurinë normale të raportimeve elektronike nga subjektet e ligjit, modernizimi i pajisjeve, rritja e kapaciteteve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Sigurimi i mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së informacionit është realizuar në vijimësi në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë të specialistëve të TI në DPPPP, me kolegët e tyre të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, DPPSH, DSIK, DPD, DPT, ASHK, BSH, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civil dhe sektorit privat. Në sajë të këtij bashkëpunimi të vazhdueshëm, DPPPP ka arritur të siguroj një qasje normale në bazat e të dhënave të këtyre institucioneve për të mundësuar një analizë të gjithanshme dhe cilësore të informacionit, për çështjet e parandalimit PP/FT.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar plotësisht të rekomandimeve përkatëse të DSIK për çështjet e sigurisë, të cilat shërbejnë si bazë për planifikimin në vijimësi të nevojave dhe trajnimin për fusha specifike.

Të dhënat që raportohen nga subjektet e ligjit, zënë peshën kryesore të informacionit që mbledh dhe përpunon DPPPP dhe për këtë qëllim është punuar pa reshtur, për të realizuar funksionimin normal të moduleve të raportimit, duke ofruar një mbështetje të vazhdueshme teknike për këto subjekte si dhe për përdoruesit e një sërë institucioneve shtetërore.

Bashkëpunimi i DPPPP në nivel ndërkombëtar, ka diktuar nevojën e sigurimit të mbarëvajtjes së funksionit të mekanizmave të shkëmbimit të sigurt të informacionit me NjIF partnere, në funksion të të cilit është realizuar një mbikëqyrje e vazhdueshme, në përputhje me standardet dhe praktikën ekzistuese të grupit Egmont.

Mjetet e komunikimit elektronik janë përdorur gjerësisht për të informuar kategori të caktuara të subjekteve të ligjit, për çështjet që janë çmuar me risk të mesëm ose të lartë për PP/FT, në përputhje dhe me praktikën tashmë të konsoliduar në DPPPP nga vitet pararendëse.

Gjatë këtij viti vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të Sektorit të TI, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja normale e funksionit të infrastrukturës së TI dhe përmbushjes së detyrave funksionale të institucionit.

# OBJEKTIVAT PËR VITIN 2020

Përparimet dhe puna e bërë gjatë vitit 2019, do të shërbejnë si pikënisje për çuarjen më tej të objektivave të vendosura në luftën dhe parandalimin e PP/FT. DPPPP mbetet e angazhuar për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor, rregulloreve dhe procedurave si dhe proceseve të punës.

Përveç objektivave ligjor të DPPPP që janë pjesë e detyrave funksionale të institucionit, gjatë vitit 2020 vëmendje të posaçme do të ketë:

- Koordinimi i masave në sistemin shqiptar të parandalimit dhe goditjes së PP/FT;
- Raportimi në ICRG/ FATF;
- Kryerja e analizës së riskut për sektorë specifikë;
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së TI;
- Konsolidimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së subjekteve të ligjit mbi bazën e riskut të PP/FT dhe bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse;
- Trajnimi i vazhdueshëm dhe cilësor i subjekteve të ligjit dhe stafit të DPPPP;



**ADRESA:**

Ministria e Financave  
dhe Ekonomisë  
Blv. "Dëshmorët e  
Kombit", Nr.3, Tiranë



**KONTAKTE:**

Tel: +355 42 24 4 602  
Mail: [info@fint.gov.al](mailto:info@fint.gov.al)  
web: [www.fiu.gov.al](http://www.fiu.gov.al)